



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.3

27 janar

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.7, datë 7.1.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.1324, datë 1.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, të ndërtesës së ish-spitalit, Poliçan, dhe një shtesë në vendimin nr.60, datë 2.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror”	25
Vendim i KM nr.8, datë 7.1.2010	Për miratimin e rregullores “Për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”	25
Vendim i KM nr.9, datë 7.1.2010	Për miratimin e rregullores “Për kategorizimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë në funksion të mbrojtjes nga rrezatimet, për sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues”	29
Vendim i KM nr.10, datë 7.1.2010	Për miratimin e rregullores “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese”	32
Vendim i KM nr.11, datë 7.1.2010	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.424, datë 12.8.2002 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e shpërblimit ditor për ushtarakët shqiptarë të dërguar në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit”, të ndryshuar	40
Vendim i KM nr.12, datë 7.1.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.556, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e shpërblimit ditor për ushtarakët shqiptarë të dërguar në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore, në kuadër të misionit ushtarak “MINURCAT” të Organizatës së Kombeve të Bashkuara”	40

Vendim i KM nr.13, datë 7.1.2010	Për caktimin e shpërblimit ditor për ushtarakët e Forcave të Armatosura të dërguar në Bosnjë-Hercegovinë, në kuadër të operacionit ushtarak “ALTHEA” të Bashkimit European	41
Vendim i KM nr.14, datë 7.1.2010	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program studimesh	42
Vendim i KM nr.15, datë 7.1.2010	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program studimesh	42
Vendim i KM nr.16, datë 7.1.2010	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimesh	43
Vendim i KM nr.17, datë 7.1.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.998, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2009-2010”	44
Vendim i KM nr.18, datë 13.1.2010	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve, nga Ministria e Brendshme Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik	45
Vendim i KM nr.19, datë 13.1.2010	Për lirin dhe mandatimin e disa anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit	47
Vendim i KM nr.23, datë 20.1.2010	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare Bërthamore	47
Udhëzim i MPCSSHB nr.127, datë 19.1.2010	Për një ndryshim në udhëzimin nr.1468, datë 26.6.2006 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.223, datë 19.4.2006 “Për pagesën e të ardhurës nga papunësia”, i ndryshuar”	49
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Ndue Dedë Deda	49

VENDIM
Nr.7, datë 7.1.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1324, DATË 1.10.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
SHËNDETËSISË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR
TË NDËRTESESË SË ISH-SPITALIT, POLIÇAN, DHE NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.60,
DATË 2.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2 të vendimit nr.1324, datë 1.10.2008 të Këshillit të Ministrave, fjalët “Qendra e trajtimit të fëmijëve, që vijnë nga familjet në gjakmarrje” ndryshohen dhe zëvendësohen me “Qendra polivalente për shërbime të përkujdesit shoqëror”.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.8, datë 7.1.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR TRAJTIMIN E SIGURT TË MBETJEVE
RADIOAKTIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Qendra e Fizikës Bërthamore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR TRAJTIMIN E SIGURT TË MBETJEVE RADIOAKTIVE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË

1. Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat kryesore për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive, që janë të detyrueshme për zbatim në të gjitha veprimtaritë që përfshijnë përpunimin, ruajtjen, transportin, shkarkimin dhe vendosjen në depon përfundimtare të mbetjeve radioaktive.

2. Përkufizime

“Mbetje radioaktive” është çdo lëndë radioaktive ose send i ndotur me lëndë radioaktive, që nuk mund të shërbejë më gjatë për qëllime të dobishme.

“Forma e mbetjes radioaktive” nënkupton formën fizike dhe kimike të mbetjeve, që, pas përpunimit dhe kondicionimit, rezulton si një masë e ngurtë, e gatshme për paketim.

“Paketim i mbetjes radioaktive” nënkupton përgatitjen e mbetjes radioaktive për transport, ruajtje ose vendosjen në depon përfundimtare, nëpërmjet mbylljes së formës së mbetjes të kondicionuar në një kontenier të përshtatshëm.

“Ruajtja e përkohshme” nënkupton vendosjen e mbetjeve radioaktive në një ndërtesë të përshtatshme, në të cilën ato ndodhen nën kontroll të vazhdueshëm për të realizuar mbrojtjen fizike të tyre dhe për të siguruar mbrojtjen e popullatës, mjedisit dhe që eventualisht janë të manipulueshme në të ardhmen.

“Depo përfundimtare” do të quhet vendi ku vendosen përfundimisht mbetjet radioaktive.

3. Institucionet përgjegjëse

a) Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet përcakton politikat në lidhje me trajtimin e mbetjeve radioaktive në bashkëpunim me institucione të linjës.

b) Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet mbron politikën që për burimet radioaktive të ardhura në vendin tonë, të krijohet mundësia e kthimit te prodhuesi.

c) Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar (QFBZ) është institucioni i ngarkuar për përpunimin e posaçëm për të gjitha mbetjet radioaktive të prodhuara në Shqipëri. Ky institucion duhet të përmbushë kushtet për licencim nga ana e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet për të gjitha këto veprimtari që lidhen me trajtimin e mbetjeve radioaktive.

4. Trajtimi i mbetjeve radioaktive

Trajtimi i mbetjeve radioaktive kryhet në përputhje me dispozitat e rregullores, duke i transformuar ato në forma të tilla, që të mos shkaktojnë rreziqe për shëndetin e njeriut dhe ndotjen e mjedisit si tani, ashtu dhe për brezat e ardhshëm.

Një nga proceset e trajtimit të mbetjeve është përpunimi, i cili përfshin grumbullimin, seleksionimin, kondicionimin dhe ruajtjen e përkohshme të mbetjeve.

Këto procese kryhen në përputhje me rregulloren e brendshme të Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar për trajtimin e mbetjeve, kapacitetet që ajo ka, të cilat duhet të miratohen në Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar.

Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar do të pranojë të gjitha ato mbetje radioaktive të prodhuara nga përdoruesit dhe që janë në përputhje me rregulloren e brendshme të Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar.

Mbetjet e tjera për të cilat ajo nuk ka kapacitet, duhet të eksportohen jashtë Shqipërisë mbi bazën e kontratave paraprake të personave juridikë e fizikë. Për të gjitha këto veprimtari, personat fizikë ose juridikë, të licencuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe që prodhojnë mbetje radioaktive, duhet të parashikojnë dhe të marrin masat e nevojshme për trajtimin e tyre në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

5. Mënyra e trajtimit të mbetjeve të lëngëta radioaktive

Mbetjet e lëngëta radioaktive që prodhohen gjatë përdorimit të lëndëve radioaktive në trajtë të hapur, me periudë përgjysmimi më të vogël se 60 ditë, grumbullohen në enë të posaçme, me vëllim rreth 1 metër kub ose më shumë.

Mbas mbushjes së enës, matet përqendrimi i radioizotopeve, si dhe aktiviteti i saj i përgjithshëm.

Kufijtë e përqendrimit dhe të aktivitetit të përgjithshëm të mbetjeve të lëngëta, që mund të derdhen në kanalizimet e zakonshme, jepen në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje në përputhje me grupin e radiotoksicitetit të radioizotopeve që jepen në shtojcën 2 të kësaj rregulloreje.

Procesi i shkarkimit të mbetjeve të lëngëta në kanalizim shoqërohet me shpëlarjen e enës, me qëllim pastrimin e enës dhe hollimin e mbetjeve radioaktive të lëngëta.

Për të gjithë këtë proces mbahen shënimet përkatëse nga ana e personave juridikë e fizikë. Gjithmonë përgjegjësia në trajtimin e mbetjeve mbetet te personat juridikë e fizikë.

Mbetjet e lëngëta radioaktive, që përmbajnë radioizotope me periodë përgjysmimi më të madhe se 60 ditë ose që emetojnë grimca alfa, grumbullohen në enë të posaçme, të cilat pas mbushjes së tyre, transferohen në Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar për përpunim të mëtejshëm.

6. Mënyra e trajtimit të mbetjeve të ngurta radioaktive

a) Mbetjet e ngurta radioaktive, që përmbajnë radioizotope me periodë përgjysmimi më të vogël se 60 ditë, ambalazhohen në mënyrë të posaçme, si thasë plastike etj., nga institucioni që i prodhon ato.

Këto paketime ruhen në vende të posaçme, që sigurojnë mbrojtje nga rrezatimet dhe kanë hyrjedalje të kontrolluara, për një periudhë kohe jo më pak se 10 perioda përgjysmimi të radioizotopit kryesor që përmban paketimi.

Pas kalimit të kësaj kohe mbetjet transferohen në Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe kryhet ekspertiza për sigurinë që përqendrimi dhe aktiviteti i përgjithshëm nuk i kalojnë kufijtë e miratuara nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.

Hedhja në mbetjet publike, në çdo rast, do të bëhet nga Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar pas një përpunimi mekanik të posaçëm, gjithmonë kur aktivitetet e përgjithshme ose përqendrimet e aktiviteve janë më të vogla se ato kufi të përcaktuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet heqjes së etiketës së radioaktivitetit nga çdo kontenier ose paketim radioaktiv, përpara se ato të transferohen në mbetjet publike.

b) Mbetjet e ngurta radioaktive me periodë përgjysmimi më të madhe se 60 ditë (përfshirë edhe burimet radioaktive të konsumuara) grumbullohen në paketime të posaçme, që sigurojnë mbrojtjen nga rrezatimi në institucionin që i prodhon. Paketimet e posaçme mbahen në vende të sigurta dhe më pas ato transferohen në Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, në vartësi të mbetjeve radioaktive të grumbulluara për përpunimin e mëtejshëm të tyre. Kostot për përpunim dhe ruajtje përballohen nga ana e personave juridikë e fizikë përgjegjës.

7. Detyrimi i përdoruesit të burimit për trajtimin e mbetjes

Përdoruesit e burimeve radioaktive, gjatë procesit të kërkesës për licencim të veprimtarive të tyre, janë të detyruar ta informojnë Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet për mënyrën e trajtimit të mbetjeve radioaktive, të shkaktuara nga këto burime ose për fatin e burimit të konsumuar. Për burimet radioaktive, në trajtë të mbyllur, duhet të parashikohet kthimi i tyre te prodhuesi, pas përfundimit të kohës së punës (konsumimit) së tyre. Në rastin kur kthimi nuk është parashikuar, si dhe në të gjitha rastet kur trajtimi i mbetjeve kryhet nga Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, përdoruesi do të nënshkruajë një kontratë me Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, në të cilën do të përcaktohen detyrimet teknike dhe financiare të palëve.

Një kopje e kësaj kontrate i bashkëngjitet dokumentacionit që përdoruesi paraqet në Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet për marrjen e licencës.

8. Transporti i mbetjeve radioaktive

Transporti i mbetjeve radioaktive të lëngëta dhe të ngurta (përfshirë burimet e konsumuara radioaktive), të cilat kërkojnë përpunim të mëtejshëm në Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, do të kryhet me mjete të posaçme për transportimin e tyre dhe në përputhje me rregulloren e transportit të sigurt të materialeve radioaktive.

9. Kondicionimi dhe ruajtja e mbetjes radioaktive

Ndërtesa për kondicionimin dhe ruajtjen e mbetjeve radioaktive në Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar duhet t'i plotësojë kushtet si për sigurinë, dhe sigurimin e aktivitetit të saj.

Në këtë ndërtesë duhet të vendoset në mënyrë të qartë (të dukshme) për stafin shenja e rrezikut radioaktiv. Ndërtesa e trajtimit të mbetjeve radioaktive në Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar duhet të sigurojë mbrojtjen fizike të mbetjeve radioaktive dhe sigurinë nga rrezatimet për punonjësit, popullatën dhe mjedisin. Sigurimi dhe siguria e saj të parashikohen në rregulloren e brendshme të saj.

10. Mbulimi i kostos së trajtimit të mbetjeve

Prodhuesit e mbetjeve radioaktive janë të detyruar të sigurojnë fondet e nevojshme për mbulimin e kostos së trajtimit të mbetjeve radioaktive, që kërkojnë përpunim të mëtejshëm dhe në çdo rast janë përgjegjës direkt për likuidimin e ndotjeve radioaktive të vendeve të punës ose të mjedisit, të shkaktuara prej tyre.

Burimet financiare për trajtimin e mbetjeve radioaktive (përfshirë burimet radioaktive të gjetura ose të konsumuara) dhe për likuidimin e ndotjeve radioaktive të mjedisit, në rastin kur nuk njihet prejardhja e tyre, do të sigurohen nga Buxheti i Shtetit.

Shtojca nr.1

KUFIJTË E PËRQENDRIMIT DHE TË AKTIVITETIT TË PËRGJITHSHËM TË RADIOIZOTOPEVE PËR MBETJET E LËNGËTA QË LËSHOHEN NË KANALIZIMET E ZAKONSHME

Nr.	Grupi i radiotoksicitetit	Aktiviteti i përgjithshëm/ditë (Bq/ditë)	Përqendrimi (Bq/l)
1	Shumë i lartë	4×10^7	4×10^3
2	I lartë	4×10^6	4×10^4
3	I mesëm	4×10^5	4×10^5
4	I ulët	4×10^4	4×10^6

Shtojca nr.2

KATEGORIZIMI I RADIOIZOTOPEVE SIPAS GRUPEVE TË RADIOTOKSICITETIT

Grupi 1 (shumë i lartë)

Pb-210, Po-210, Ra-223, Ac-227, Th-228, Th-230, Pa-231, U-230, U-232, U-233, U-234, Np-237, Pu-238, Pu-239, Pu-240, Am-241, Am-243, Cm-242, Cm-243, Cm-244, Cm-245, Cm-246, Cf-250, Cf-252.

Grupi 2 (i lartë)

Na-22, Cl-36, Ca-54, Sc-46, Mn-54, Co-56, Co-60, Sr-89, Sr-90, Y-91, Zr-95, Ru-106, Ag-110m, Cd-115m, In-115m, Sb-124, Sb-125, Te-127m, I-124, I-125, I-126, I-131, Cs-134, Cs-137, Ba-140, Ce-144, Eu-152, Eu-154, Tb-160, Tm-170, Hf-181, Ta-182, Ir-192, Ti-204, Bi-207, At-211, Pb-212, Ra-224, Ac-228, Pa-230, Th-234, U-236.

Grupi 3 (i mesëm)

Be-7, C-14, F-18, Na-24, Cl-38, Si-32, P-32, Ar-41, K-41, K-43, Ca-47, Sc-47, Cs-48, V-48, Mn-52, Mn-56, Fe-52, Fe-55, Fe-59, Co-57, Co-58, Ni-63, Cu-64, Zn-65, Zn-69, Ga-72, As-73, As-74, As-77, Se-75, Br-82, Kr-85m, Kr-87, Rb-86, Sr-91, Y-90, Y-93, Zr-97, Nb-93, Nb-95, Mo-99, Tc-96, Tc-97m, Tc-99, Ru-97, Ru-103, Ru-107, Rh-105, Pd-103, Pd-109, Ag-105, Ag-111, Cd-109, Cd-115, In-115m, Sn-113, Sn-125, Sb-122, Te-125m, Te-127, Te-129, Te-131m, Te-132, I-132, I-130, I-134, I-135, Xe-135, Cs-131, Cs-136, Ba-131, La-140, Ce-141, Ce-143, Pr-142, Nd-147, Nd-149, Pm-147, Pm-149, Sm-151, Sm-153, Eu-152m, Eu-155, Gd-153, Gd-159, Dy-165, Dy-166, Ho-166, Er-169, Er-171, Tm-171, Yb-175, Lu-177, Ę-185, Ę-187, Re-183, Re-186, Re-188, Os-185, Os-191, Os-193, Ir-190, Ir-194, Pt-191, Pt-193, Pt-197, Au-196, Au-198, Au-199, Hg-197, Hg-197m, Hg-203, Tl-200, Tl-201, Tl-202, Pb-202, Bi-206, Bi-212, Rn-220, Th-231, Pa-233, Np-239.

Grupi 4 (i ulët)

H-3, O-15, Ar-37, Co-58m, Ni-59, Zn-69, Ge-71, Kr-85, Sr-85, Rb-87, Y-91m, Zr-93, Nb-97, Tc-96m, Tc-99m, Rh-133m, In-133m, I-129, Ze-131m, Xe-133, Cs-134m, Cs-136, Sm-147, Re-187, Os-191m, Pt-193m, Pt-197m, Th-232, Th-Nat, U-235, U-238, U-Nat.

VENDIM
Nr.9, datë 7.1.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KATEGORIZIMIN E BURIMEVE RADIOAKTIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NË FUNKSION TË MBROJTJES NGA RREZATIMET, PËR SIGURINË DHE SIGURIMIN E BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për kategorizimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë në funksion të mbrojtjes nga rrezatimet, për sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE

PËR KATEGORIZIMIN E BURIMEVE RADIOAKTIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NË FUNKSION TË MBROJTJES NGA RREZATIMET, PËR SIGURINË DHE SIGURIMIN E BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES

1. Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i një sistemi logjik të thjeshtë për kategorizimin e materialeve radioaktive, bazuar në rrezikun e tyre potencial ndaj shëndetit. Kategorizimi i burimeve bazuar në riskun, aktivitetin dhe praktikën e punës me to, është një domosdoshmëri për plotësimin e kushteve të sigurisë dhe sigurimit.

2. Elemente bazë për vlerësimin e kategorizimit

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, bazuar në dokumente të ANEA-s, ka arritur të krijojë një sistem, i cili i shpërndan burimet në pesë kategori duke marrë në konsideratë këto elemente bazë:

- Sistemin e licencimit;
- Masat e sigurimit fizik;
- Regjistrin kombëtar të burimeve radioaktive;
- Kontrollin e import-eksporteve të burimeve radioaktive;
- Etiketimin e burimeve radioaktive me aktivitet të madh;
- Planin e emergjencave;
- Prioritetin për vënien në kontroll të burimeve me status të dyshimtë;
- Komunikimin me publikun.

3. Efektet e materialeve radioaktive sipas kategorive

- Kategoria 1 e burimeve, nëse nuk është menaxhuar në mënyrë të sigurt ose nuk është mbrojtur në mënyrë të sigurt, mund të shkaktojë dëmtime të përhershme te personi që i përdor ose ka qenë në kontakt me to, për më shumë se disa minuta. Do të ishte me pasoja vdekjeprurëse qëndrimi afër një sasive materiali të pambrojtur për një periudhë nga disa minuta deri në një orë. Këto burime përdoren veçanërisht në praktika të tilla, si gjeneratorët me burim radioaktiv, rrezatuesit e fuqishëm dhe burimet e radioterapisë.

- Kategoria 2 e burimeve, nëse nuk është menaxhuar në mënyrë të sigurt ose nuk është mbrojtur në mënyrë të sigurt, mund të shkaktojë dëmtime të përhershme te personi, që i mban ose ka qenë në

kontakt me to për një kohë relativisht të shkurtër (minuta deri në disa orë). Do të ishte me pasoja vdekjeprurëse qëndrimi afër një sasive materiali radioaktiv të pambrojtur për një periudhë nga disa orë deri në disa ditë. Këto burime përdoren veçanërisht në praktika të tilla, si radiografia industriale gama, brakiterapia me fuqi doze të lartë dhe me fuqi doze të mesme.

- Kategoria 3 e burimeve, nëse nuk është e menaxhuar në mënyrë të sigurt ose nuk është mbrojtur në mënyrë të sigurt, mund të shkaktojë dëmtime të përhershme te personi, që i mban ose ka qenë në kontakt me to për më shumë se disa orë. Do të ishte me pasoja vdekjeprurëse, ndonëse me mundësi të pakta, qëndrimi afër një sasive materiali radioaktiv të pambrojtur për një periudhë nga disa ditë në disa javë. Këto burime përdoren veçanërisht në praktika të tilla, si sondat fikse industriale që kanë burime me aktivitet të lartë (si p.sh. në nivelmatësat, sondat e konvejerëve, trashësimatësat) dhe kontrolli i puseve të shpimit.

Në kategoritë 4 dhe 5 përfshihen burime me risk të ulët, krahasuar me tri kategoritë e mësipërme.

4. Kategorizimi i materialeve radioaktive

Kategorizimi i burimeve bazohet në raportin A/D, ku “A” është aktiviteti i burimit, ndërsa “D” është një faktor që quhet faktori i rrezikut dhe përcaktohet bazuar në faktorin e transferimit linear të energjisë së rrezatimit TLE. Përcaktimi bëhet mbi bazën e tabelës 1, vlerat e “D”-së jepen në tabelën 2.

Tabela 1

Kategoria	Praktikat e përdorimit	A/D
1	Gjenerator termoelektrik me radioizotope Rrezatime Teleterapi Fikse dhe multi bem teleterapi	≥ 1000
2	Gamma radiografi industriale Brakiterapi me nivel të mesëm dhe të lartë doze	$1000 > A/D > 10$
3	Deduktuesit industrialë fikse Deduktus niveli Numërues Deduktues në puse	$10 > AD > 1$
4	Brakiterapi me nivel të ulët doze (përfshijë burimet e implantuara) Deduktues trashësie dhe niveli Deduktues portabël Përcaktimi i densitetit të kockave Eliminuesit e ngarkesave	$1 > A/D > 0.01$
5	Brakiterapi me nivel të ulët doze (përfshijë burimet e implantuara) Fluoreshenca me rreze x Pajisje për kapjen e elektroneve Spektroskopinë Mossbauer Tomografia me emision pozitronesh	$0.001 > A/D > \text{përfshijëtimet}/D$

Burimet me periudhë gjysmëzbërthimi të vogël, të cilat përdoren në mjekësinë bërthamore, si Tc-99 ose I-131, mund të përfshihen në kategorizim dhe inventar, por kjo duhet të shihet rast pas rasti (ose përjashtohen).

Praktikat, të cilat përfshijnë grupimin e disa burimeve në një zonë ku ato qëndrojnë së bashku, si në ruajtje dhe në transport mund të konsiderohen si një burim i vetëm. Në këtë rast përcaktimi i kategorisë do të bëhet:

$$A/D = \sum_n (\Sigma_i A_{i,n}) / D_n$$

Ku “A_{i,n}” është aktiviteti për çdo burim “i”, të radionuklidit “n” dhe “D_n” është vlera e “D” për çdo radionuklid.

Faktori i rrezikut “D” i referohet kritereve të mëposhtme të dozës.

1. “1Gy” në palcën e kockave ose “6 Gy” në mushkëri prej një rrezatimi të ulët TLE (faktori i transformimit linear të energjisë), i marrë nga një organ, në 2 ditë.
2. “25 Gy” në mushkëri nga përthithja prej një rrezatimi të lartë TLE në 1 vit.
3. “5 Gy” në tiroide e përthithur nga organi, në 2 ditë.
4. Për një burim në kontakt me indin e butë, një dozë më shumë se 25 Gy në thellësi.
a-2 cm për pjesët kryesore të trupit,
b-1 cm për duart.
5. Për një burim, i cili konsiderohet shumë i madh për t’u mbajtur, 1 Gy në palcën e kockave në 100 orë nga një burim në dhomë në distancë 1 m.

Tabela 2

Radionuklidi	1000*D		10*D		D		0.01*D	
	TBq	Ci	TBq	Ci	TBq	Ci	TBq	Ci
Am-241	6.E+01	2.E+03	6.E-01	2.E+01	6.E-02	2.E+00	6.E-04	2.E-02
Am241/Be	6.E+01	2.E+03	6.E-01	2.E+01	6.E-02	2.E+00	6.E-04	2.E-02
Au-198	2.E+02	5.E+03	2.E+00	5.E+01	2.E-01	5.E+00	2.E-03	5.E-02
Cd-109	2.E+04	5.E+05	2.E+02	5.E+03	2.E+01	5.E+02	2.E-01	5.E+00
Cf-252	2.E+01	5.E+02	2.E-01	5.E-00	2.E-02	5.E-01	2.E-04	5.E-03
Cm-244	5.E+01	1.E+03	5.E-01	1.E+01	5.E-02	1.E+00	5.E-04	1.E-02
Co-57	7.E+02	2.E+04	7.E+00	2.E+02	7.E-01	2.E+01	7.E-03	2.E-01
Co-60	3.E+01	8.E+02	3.E-01	8.E+00	3.E-02	8.E-01	3.E-04	8.E-03
Cs-137	1.E+02	3.E+03	1.E+00	3.E+01	1.E-01	3.E+00	1.E-03	3.E-02
Fe-55	8.E+05	2.E+07	8.E+03	2.E+05	8.E+02	2.E+04	8.E+00	2.E+02
Gd-153	1.E+03	3.E+04	1.E+01	3.E+02	1.E+00	3.E+01	1.E-02	3.E-01
Ge-68	7.E+01	2.E+03	7.E-01	2.E+01	7.E-02	2.E+00	7.E-04	2.E-02
H-3	2.E+06	5.E+07	2.E+04	5.E+05	2.E+03	5.E+04	2.E+01	5.E+02
I-125	2.E+02	5.E+03	2.E+00	5.E+01	2.E-01	5.E+00	2.E-03	5.E-02
I-131	2.E+02	5.E+03	2.E+00	5.E+01	2.E-01	5.E+00	2.E-03	5.E-02
Ir-192	8.E+01	2.E+03	8.E-01	2.E+01	8.E-02	2.E+00	8.E-04	2.E-02
Kr-85	3.E+04	8.E+05	3.E+02	8.E+03	3.E+01	8.E+02	3.E-01	8.E+00
Mo-99	3.E+02	8.E+03	3.E+00	8.E+01	3.E-01	8.E+00	3.E-03	8.E-02
Ni-63	6.E+04	2.E+06	6.E+02	2.E+04	6.E+01	2.E+03	6.E-01	2.E+01
P-32	1.E+04	3.E+05	1.E+02	3.E+03	1.E+01	3.E+02	1.E-01	3.E+00
Pd-103	9.E+04	2.E+06	9.E+02	2.E+04	9.E+01	2.E+03	9.E-01	2.E+01
Pm-147	4.E+04	1.E+06	4.E+02	1.E+04	4.E+01	1.E+03	4.E-01	1.E+01
Po-210	6.E+01	2.E+03	6.E-01	2.E+01	6.E-02	2.E+00	6.E-04	2.E-02
Pu-238	6.E+01	2.E+03	6.E-01	2.E+01	6.E-02	2.E+00	6.E-04	2.E-02
Pu-239/Be	6.E+01	2.E+03	6.E-01	2.E+01	6.E-02	2.E+00	6.E-04	2.E-02
Ra-226	4.E+01	1.E+03	4.E-01	1.E+01	4.E-02	1.E+00	4.E-04	1.E-02
Ru-106(Rh-106)	3.E+02	8.E+03	3.E+00	8.E+01	3.E-01	8.E+00	3.E-03	8.E-02
Se-75	2.E+02	5.E+03	2.E+00	5.E+01	2.E-01	5.E+00	2.E-03	5.E-02
2Sr-90(Y-90)	1.E+03	3.E+04	1.E+01	3.E+02	1.E+00	3.E+01	1.E-02	3.E-01
Tc-99	7.E+02	2.E+04	7.E+00	2.E+02	7.E-01	2.E+01	7.E-03	2.E-01
Tl-204	2.E+04	5.E+05	2.E+02	5.E+03	2.E+01	5.E+02	2.E-01	5.E+00
Tm-170	2.E+04	5.E+05	2.E+02	5.E+03	2.E+01	5.E+02	2.E-01	5.E+00
Yb-169	3.E+02	8.E+03	3.E+00	8.E+01	3.E-01	8.E+00	3.E-03	8.E-02

VENDIM
Nr. 10, datë 7.1.2010

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR LICENCIMIN DHE INSPEKTIMIN E
VEPRIMTARIVE ME BURIME TË RREZATIMEVE JONIZUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, dhe të nenit 5 të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
**PËR LICENCIMIN DHE INSPEKTIMIN E VEPRIMTARIVE ME BURIME TË RREZATIMEVE
JONIZUESE**

1. Objekti i rregullores

Në zbatim të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, kjo rregullore përcakton:

- a) procedurat e licencimit, të personave fizikë dhe juridikë, që është subjekt i ligjit sipas nenit 3 të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar;
- b) kriteret e posaçme që duhet të plotësojnë këto subjekte;
- c) afatet e shqyrtimit apo vendimmarrjes së licencës;
- d) procedurat e revokimit;
- e) mënyrën e inspektimit dhe kontrollit të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, që lidhen me rrezatimin nga ana e subjekteve të licencuara.

2. Përjashtimet

Përjashtohen ose nuk përfshihen fare nga detyrimet e kësaj rregulloreje praktikat dhe burimet siç përcaktohen në listën e miratuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi (KMR).

3. Licencimi

- Çdo person juridik ose fizik që ushtron veprimtaritë e përcaktuara në nenin 3 të ligjit 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar, është i detyruar të pajiset me licencë nga KMR.

- Kriteret bazë mbi të cilat mbështetet aplikimi për licencë janë sigurimi, siguria dhe mbrojtja nga rrezatimet sipas formularëve bashkëngjitur kësaj rregulloreje. Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtaritë e mësipërme, subjekti duhet të përmbushë kriteret e posaçme, si më poshtë:

- Përshtatshmëria e njohurive dhe e eksperiencës së personelit në mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin.

- Përshtatshmëria fiziko-shëndetësore e personelit.

- Siguria dhe sigurimi nga rrezatimi jonizues.

- Justifikimi, optimizimi dhe kufizimi i dozave.

- Siguria e origjinës, transportit, përdorimit dhe trajtimit të burimit në fund të jetës dhe ose veprimtarisë.

- Përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit.

- Përshtatshmëria e rregullave për punë të sigurt për veprimtari normale, si dhe në raste emergjencash.

- Për marrjen e licencës subjekti duhet t'i drejtohet KMR-së për aplikim jo më vonë se 90 ditë pune përpara parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Kërkesa bëhet nëpërmjet aplikimit për licencë në ZMR.

- Nëpërmjet inspektorëve të saj, KMR-ja bën shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur, kërkon dokumente shtesë kur është e nevojshme dhe njëkohësisht bëhet verifikimi në vend dhe lëshohet një dokument vlerësimi nga ana e inspektorëve të zyrës për mbrojtjen nga rrezatimi, i cili merr në konsideratë mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin.

- Pas vlerësimit nga ZMR-ja, dërgohet në KMR për miratim. Ekspertiza në lidhje me mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin realizohet nga përdoruesit, persona fizikë e juridikë me mbështetjen e ekspertëve në këto fusha (të njohur nga ana e KMR-së), por gjithmonë mbetet përgjegjësi e plotë e aplikantit mbrojtja nga rrezatimet, siguria dhe sigurimi.

- Në rastin e ndërtimit me faza të një praktike, e cila përfshin aktivitetet e përshkruara në nenin 3 të ligjit, bëhet miratimi paraprak për plotësimin e mëtejshëm të aplikimit.

- Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të aplikimit, jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit dhe njofton me shkrim përdoruesin;

- Për çdo përdorues mbahet një dosje, e cila në rastin e rinovimit, plotësohet me elementet shtesë dhe kërkesat e KMR-së. Ngarkohet ZMR-ja për plotësimin dhe mirëmbajtjen e arkivit të dosjeve të tij.

- ZMR-ja, pas miratimit të licencës nga KMR-ja, përgatit licencën për subjektin përkatës sipas formatit të miratuar nga KMR-ja.

- Procedurat e vlerësimit të aplikimit për licencë miratohen me vendim të KMR-së.

4. Afati i vlefshmërisë së licencës

Licenca jepet për një periudhë 5-vjeçare. Pas kalimit të këtij afati ajo bëhet e pavlefshme.

Të paktën dy muaj përpara mbarimit të afatit të licencës, përdoruesi është i detyruar ta njoftojë me shkrim KMR-në për pushimin ose mbylljen e aktivitetit. Në çdo rast përdoruesi është i detyruar t'i zbatojë procedurat për mbylljen e aktivitetit duke marrë të gjitha masat për likuidimin e ndonjë kontaminimi të mundshëm radioaktiv ose masa të tjera që sigurojnë ambientin dhe publikun.

Nëse mbajtësi i saj kërkon rinovimin e licencës, KMR-ja vepron sipas procedurës së përshkruar në pikën 3 të kësaj rregulloreje. Personat fizikë ose juridikë duhet të njoftojnë ZMR-në për çdo ndryshim, modifikim eventuale të veprimtarisë që ata kryejnë ose burimeve siç është parashikuar në licencë për një afat dy muaj përpara ndryshimit. Shtesat e burimeve radioaktive në licencë brenda kategorisë bëhen vetëm me ndryshimin e shtojcës për burimet duke njoftuar dhe me miratim nga ZMR-ja.

Në rastin kur Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet arrin në përfundimin se si rezultat i ushtrimit të një veprimtarie që përmbahet në nenin 3 të ligjit krijohet rrezik për shëndetin e punonjësve, të popullatës ose për dëmtimin e mjedisit, i refuzon dhënien e licencës personit fizik ose juridik që e kërkon atë ose kur veprimtaria është e licencuar, i heq atij licencën.

5. Inspektimi

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet nëpërmjet inspektorëve kontrollon zbatimin e dispozitave që lidhen me mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin e të gjitha veprimtarive të licencuara. Inspektorët pajisen me fletënjuhje lëshuar nga ky Komision. Statusin e inspektorit të mbrojtjes nga rrezatimet e përfitojnë për shkak të detyrës punonjësit e zyrës së mbrojtjes nga rrezatimet .

6. Detyrat e inspektorëve

Inspektorët e ZMR-së kanë për detyrë:

1. Të inspektojnë dhe kontrollojnë çdo pajisje me lëndë radioaktive ose pajisje tjetër rrezatuese (aparate Rontgeni etj.) dhe çdo objekt që dyshohet se ka lëndë radioaktive ose është pajisje rrezatuese, si dhe të kryejnë ekzaminime të tjera bazë për t'u siguruar që masat mbrojtëse nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin janë zbatuar plotësisht.

2. Të kërkojnë nga personat që ushtrojnë veprimtari të licencuar sipas nenit 3 të ligjit, dokumente dhe regjistra që lidhen me veprimtarinë e ushtruar, si dhe të kërkojnë informacione lidhur me përmbajtjen e këtyre dokumenteve.

3. Kanë të drejtë të pyesin dhe të kërkojnë shpjegime mbi ushtrimin e praktikës dhe përdorimin e burimeve. Inspektorët kanë të drejtë të marrin kopje ose ekstrakte nga këto dokumente. Inspektorët duhet të ruajnë konfidencialitetin e materialeve dhe biznesit. Materialet depozitohen në dosjen përkatëse në ZMR.

7. Veprimet e inspektorëve kur i licencuari paraqet rrezikshmëri

Në rastin kur inspektorët, në bazë të rezultateve të kontrollit, arrijnë në përfundimin se një veprimtari ndonëse e licencuar paraqet rrezik për punonjësit, publikun ose për mjedisin, ata kanë të drejtë të kryejnë këto veprime:

a) Të vendosin nën kontroll dhe ruajtje të gjitha pajisjet që përfshihen në veprimtarinë që paraqet rrezik.

b) Të pezullojnë përkohësisht punën e të gjitha pajisjeve dhe aparaturave.

c) Të urdhërojnë marrjen e masave të nevojshme për pastrimin e ndotjeve radioaktive nga pajisjet, vendet e punës ose nga objektet e tjera të ndotura dhe çdo lloj mase tjetër që lidhet me sigurinë dhe sigurimin.

8. Të drejtat e inspektorëve

Gjatë ushtrimit të detyrave që parashikohen në pikat 6 dhe 7, inspektorët kanë të drejtë:

a) Të hyjnë në çdo kohë të përshtatshme në vendet ku kryhen veprimtari të parashikuara në nenin 3 të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar ose në vende që dyshohen se kryejnë veprimtari të tilla.

b) Të urdhërojnë personat juridikë e fizikë që të mos kryejnë veprime që do të krijonin ose rëndonin një situatë emergjence radiologjike.

KMR-ja përcakton mënyrën e përgatitjes së raportit të inspektimit.

Në rastin kur një person juridik ose fizik pengon kryerjen e detyrave të një inspektori ose kundërshton veprimet e tij sipas pikave 6, 7 dhe 8, ai quhet fajtor dhe ndëshkohet me gjobë për kundërvajtje administrative sipas ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar. Të drejtën e vendosjes së gjobave e kanë inspektorët e zyrës së mbrojtjes nga rrezatimet.

9. Ndrejja e të metave nga subjekti i licencuar

Për të gjitha konstatimet e inspektorëve gjatë ushtrimit të kontrolleve, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet ushtron kompetencat mbi personat që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në rregullore për ndrejqen e të gjitha të metave të konstatuara deri në një afat të caktuar nga inspektori dhe verifikohen nëpërmjet një inspektimi të ri. Moskorrigjimi i të metave nga ana e personave çon në pezullimin e licencës e deri në heqjen e saj.

10. Ankimimi i vendimeve

Kundër vendimit të inspektorit, subjekti i licencuar ka të drejtë të ankohet pranë Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet brenda 15 ditëve.

Kundër vendimit të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, subjekti i licencuar ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja njoftim e vendimit.

APLIKIMI PËR LICENCË PËR VEPRIMTARI ME BURIME TË MBYLLURA RADIOAKTIVE

KËRKESE PËR LICENCË

PËR VEPRIMTARI ME BURIME TË RREZATIMEVE JONIZUESE
Burime të mbyllura dhe të hapura radioaktive

Aplikim i ri _____
Amendim i licencës _____
Rinovim i licencës _____

1. Personi juridik/ fizik : Institucioni _____
Emri, mbiemri _____
Adresa _____
Adresa e kabinetit n.q.s është e ndryshme nga më sipër _____
Tel _____
Fax _____
E-mail _____

Bashkëngjitur paraqit një kopje të regjistrimit të personit juridik/fizik në QKR.

2. Përshkruani ambientet ku kryhet veprimtaria me rrezatime jonizuese.

Paraqisni veças planimetrinë e ambienteve, vendndodhjes së burimit, pajisjeve mbrojtëse të lëvizshme, dyerve, dritareve, ventilatorëve, pasazheve, dhomës së errët, ambienteve të pritjes, qëndrimin e personelit, ambientet rreth kabinetit, materialin dhe trashësinë e mureve dhe madhësitë përkatëse, dimensionet. Paraqit planin e sigurisë fizike sipas grupit të sigurisë. Të dokumentohet destinacioni i ambienteve.

Importimi, përfitimi i burimit.

3. Lloji i burimit radioaktiv:

Prodhuesi _____
Emri i prodhuesit _____
Adresa e prodhuesit _____
Radionuklidi _____
Modeli _____
Aktiviteti fillestar _____
Energjitë _____
Forma kimike dhe fizike _____
Seria _____

Bashkëngjit fletë shtesë në të njëjtën strukturë si më sipër në rast se janë më shumë se një burim.

4. Qëllimi i përdorimit të burimit radioaktiv _____

5. Përcakto kush do të jetë shërbimi i autorizuar, i cili do të kryejë shërbimet e pajisjeve që përdorin burimin. _____

6. Jep një performancë të dozave në ambientet publike, në ato të kontrolluara dhe të survejuara.
Jep një informacion mbi justifikimin, optimizimin dhe kufizimin në dozat limit për aktivitetin _____

7. Struktura organizative

Paraqit bashkëngjitur dokumente mbi strukturën organizative. Paraqit dokumentacionin në lidhje me kualifikimet dhe eksperiencat e stafit. Strategjia e kontrollit fizik dhe e mbrojtjes nga rrezatimet. Jep listën e punonjësve që do të manipulojnë me burimin dhe gjithashtu kualifikimet e tyre dhe personave që kanë akses në zonat e kontrolluara.

8. Për monitorimin dhe kontrollin e dozës së ekspozimit gjatë punës me rrezatimet jonizuese kërkohet realizimi i një kontrate me Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Tiranë.

Paraqisni një kopje të kontratës.

9. Të dhëna mbi personin përgjegjës për sigurinë ndaj rrezatimit

Emri _____

Mbiemri _____

Profesioni _____

Kualifikimi në fushën e radiombrojtjes

Paraqit një kopje të kontratës së punës.

10. Përshkruani masat e sigurisë dhe procedurat e trajtimit të aksidenteve të mundshme lidhur me pajisjet që keni në përdorim.

11. Të paraqiten dokumente, nëpërmjet të cilave vërtetohet që burimi i konsumuar do të trajtohet në qendrat përkatëse të mbetjeve në fund të përdorimit .

12. Dokumentacioni

Mënyra e ruajtjes së dokumentacionit për dozimetrinë personale, izodozave, incidenteve, trajnimit, shërbimeve të pajisjeve dhe kontrolli mjekësor periodik i punonjësve.

13. Të bëhet një vlerësim me shkrim nga ana e përdoruesit nëpërmjet ekspertëve për mbrojtjen nga rrezatimi, sigurinë dhe sigurimin.

14. Paraqisni një dokument mbi kontrollin mjekësor periodik të punonjësve, që punojnë me burime të rrezatimit jonizues.

Për sa më sipër, kërkohet dhënien e licencës për _____ duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

Data _____

Nënshkrimi _____

I gjithë dokumentacioni të jetë në origjinal, i noterizuar ose me vulë lidhëse të institucionit tuaj .
Pas plotësimit me kujdes të rubrikave të këtij formulari, dërgojeni atë së bashku me dokumentet e tjera të nevojshme, në adresën e mëposhtme:

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

Instituti i Shëndetit Publik

Aleksandër Moisiu, 80

Tiranë

Dërgimi i një kërkesë të paplotësuar në mënyrë të rregullt dhe të plotë do të sjellë vonesa, për të cilat përgjegjësia bie mbi kërkuesin e licencës. Bazuar në nenin 3 të rregullores për licencim dhe inspektim për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik i drejtohet me një kërkesë ZMR-së. Mbas kërkesës, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për lëshimin ose moslëshimin e licencës jo më vonë se 90 ditë pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

Shënim.

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me ligjin nr.8025, datë 9.11.1995, të ndryshuar, si dhe të rregullores, kodeve dhe praktikave të aprovuara.

2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

3. Tërheqja e burimeve të rrezatimeve jonizuese nga pikat doganore, në bazë të njoftimit të bërë në ZMR (formulari), bëhet në bazë të një lejeje që jepet nga ZMR-ja ose KMR-ja.

INSPEKTIMI PËR DHËNIEN E LICENCËS

1. Lloji i burimeve të rrezatimeve jonizuese:

2. Dokumentacioni. Të shënohen kutitë e mëposhtme mbi bazën e materialeve bashkëngjitur dhe të firmoset nga inspektori.

- Aplikimi;
- Kopje e regjistrimit në QKL;
- Importi;
- Servisi;
- Planimetria;
- Dokumentacion për pajisjen nr. i faqeve;
- Kontratë për dozimetinë Personale;
- Kualifikimet e personelit;
- Plani i emergjencave;
- Performanca e dozave;
- Vlerësimi i sigurisë dhe sigurimit;
- Kontrolli mjekësor.

Data _____ Inspektori: Emri, mbiemri, Firma _____

LICENCIMI

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, pasi analizoi kërkesën, aprovoi dhënien e licencës për një afat _____ vjeçar.

Data _____

Kryetari i ZMR

APLIKIMI PËR LICENCË PËR VEPRIMTARI ME GJENERATORË ME RREZE X

KËRKESE PËR LICENCË

PËR VEPRIMTARI ME BURIME TË RREZATIMEVE JONIZUESE

Gjeneratorë me rreze x

Aplikim i ri _____

Amendim i licencës _____

Rinovim i licencës _____

1. Personi juridik/fizik : Institucioni _____

Emri, mbiemri _____

Adresa _____

Adresa e kabinetit n.q.s është e ndryshme nga më sipër _____

Tel _____

Fax _____

E-mail _____

Bashkëngjitur paraqit një kopje të regjistrimit të personit juridik/fizik në QKR.

2. Përshkruani ambientet ku kryhet veprimtaria me rrezatime x.

Paraqisni veças planimetrinë e ambienteve, vendndodhjes së panelit të kontrollit, pajisjeve mbrojtëse të lëvizshme, dyerve, dritareve, ventilatorëve, pasazheve, dhomës së errët, ambienteve të

pritjes së pacientëve, qëndrimin e personelit, ambientet rreth kabinetit, materialin dhe trashësinë e mureve dhe madhësitë përkatëse, dimensionet. Zonat e kontrolluara dhe të survejuara. Të dokumentohet destinacioni i ambienteve

Importimi, përfitimi i pajisjes.

3. Lloji i gjeneratorit me rreze x:

Prodhuesi _____
Emri _____
Adresa _____
Tensioni maksimal _____
Rryma maksimale _____
Koha javore e ekspozimit _____
Ngarkesa javore (numri) _____
Numri i tubave _____
Model _____
Seria _____

Bashkëngjit fletë shtesë në të njëjtën strukturë si më sipër në rast se janë më shumë se një pajisje.

4. Qëllimi i përdorimit të gjeneratorëve me rreze x _____

5. Përcakto kush do të jetë shërbimi i autorizuar, i cili do të kryejë shërbimet e pajisjeve

6. Jep një performancë të dozave në ambientet publike, në ato të kontrolluara dhe të survejuara.
Jep një informacion mbi justifikimin, optimizimin dhe kufizimin në dozat limit për aktivitetin _____

7. Struktura organizative

Paraqit bashkëngjitur dokumente mbi strukturën organizative. Paraqit dokumentacionin në lidhje me kualifikimet dhe eksperiencat e stafit. Strategjinë e mbrojtjes nga rrezatimet .Jep listën e punonjësve që do të manipulojë me pajisjen dhe gjithashtu kualifikimet e tyre dhe personave që kanë akses në zonat e kontrolluara.

8.Për monitorimin dhe kontrollin e dozës së ekspozimit gjatë punës me rrezatimet jonizuese, kërkohet realizimi i një kontrate me Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Tiranë.

Paraqisni një kopje të kontratës.

9. Të dhëna mbi personin përgjegjës për sigurinë ndaj rrezatimit

Emri _____

Mbiemri _____

Profesioni _____

Kualifikimi në fushën e radiombrojtjes _____

Paraqit një kopje të kontratës së punës.

10. Përshkruani masat e sigurisë dhe procedurat e trajtimit të aksidenteve të mundshme lidhur me pajisjet që keni në përdorim.

11.Rregullat e brendshme dhe supervizimi

Të paraqitet një informacion mbi funksionimin e brendshëm të Qendrës, kabinetit në formë kodi ose në çdo formë tjetër.

12. Dokumentacioni

Mënyra e ruajtjes së dokumentacionit për dozimetrinë personale, izodozave, incidenteve, trajnimit, shërbimeve të pajisjeve dhe kontrolli mjekësor periodik i punonjësve.

13. Të bëhet vlerësimi për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi.

14. Paraqisni një dokument mbi kontrollin mjekësor periodik të punonjësve që punojnë me gjeneratorë me rreze x.

Për sa më sipër, kërkoj dhënie të licencës për _____ duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

Data _____

Nënshkrimi _____

I gjithë dokumentacioni të jetë në origjinal, i noterizuar ose me vulë lidhëse të institucionit tuaj.

Pas plotësimit me kujdes të rubrikave të këtij formulari, dërgojeni atë së bashku me dokumentet e tjera të nevojshme, në adresën e mëposhtme:

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet
Instituti i Shëndetit Publik
Aleksandër Moisiu, 80
Tiranë

Dërgimi i një kërkesë të paplotësuar në mënyrë të rregullt dhe të plotë do të sjellë vonesa, për të cilat përgjegjësia bie mbi kërkuesin e licencës. Bazuar në nenin 3 të rregullores për licencim dhe inspektim për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik i drejtohet me një kërkesë ZMR-së. Mbas kërkesës, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për lëshimin ose moslëshimin e licencës, jo më vonë se 90 ditë pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

Shënim.

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me ligjin nr.8025, datë 9.11.1995, i ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.

2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

3. Tërheqja e burimeve të rrezatimeve jonizuese nga pikat doganore, në bazë të njoftimit të bërë në ZMR (formulari) bëhet në bazë të një lejeje që jepet nga ZMR-ja ose KMR-ja.

INSPEKTIMI PËR DHËNIEN E LICENCËS

1. Lloji i burimeve të rrezatimeve jonizuese:

2. Dokumentacioni. Të shënohen kutitë e mëposhtme mbi bazën e materialeve bashkëngjitur dhe të firmoset nga inspektori.

- Aplikimi;
- Kopje e regjistrimit në QKL;
- Importi;
- Servisi;
- Planimetria;
- Dokumentacion për pajisjen nr. i faqeve;
- Kontratë për dozimetrinë personale;
- Kualifikimet e personelit;
- Plani i emergjencave;
- Performanca e dozave;
- Vlerësimi për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet;
- Kontrolli mjekësor.

Data _____ Inspektori: Emri, mbiemri, Firma _____

LICENCIMI

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, pasi analizoi kërkesën, aprovoi dhënien e licencës për një afat _____ vjeçar.

Data _____

Kryetari i ZMR

VENDIM
Nr.11, datë 7.1.2010

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.424, DATË 12.8.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT DITOR PËR USHTARAKËT SHQIPTARË TË DËRGUAR NË AFGANISTAN, NË KUADËR TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr.8932, datë 25.7.2002 “Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.424, datë 12.8.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ky ndryshim dhe kjo shtesë:

a) Në pikën 1 fjalët “...të jetë 60 (gjashtëdhjetë) dollarë amerikanë...” zëvendësohen me “...të jetë 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë, për nivelin e parë të rrezikshmërisë, dhe 9 000 (nëntë mijë) lekë, për nivelin e dytë të rrezikshmërisë...”.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Ministri i Mbrojtjes përcakton nivelin e rrezikshmërisë për trupat që do të marrin pjesë në mision, në bazë të tabelës së vlerësimit të rrezikshmërisë.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.12, datë 7.1.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.556, DATË 28.5.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT DITOR PËR USHTARAKËT SHQIPTARË TË DËRGUAR NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE REPUBLIKËN E AFRIKËS QENDRORE, NË KUADËR TË MISIONIT USHTARAK “MINURCAT” TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të aktit normativ nr.1, datë 2.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin e një kompanie të Forcave të Armatosura në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë në misionin “MINURCAT”, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara”, miratuar me ligjin nr.10114, datë 2.4.2009, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.556, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave, fjalët "...të jetë 60 (gjashtëdhjetë) euro ..." zëvendësohen me "...të jetë 9 000 (nëntë mijë) lekë...".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.13, datë 7.1.2010

**PËR CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT DITOR PËR USHTARAKËT E FORCAVE TË
ARMATOSURA TË DËRGUAR NË BOSNJË-HERCEGOVINË, NË KUADËR TË
OPERACIONIT USHTARAK "ALTHEA" TË BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ nr.2, datë 8.4.2008 "Për dërgimin në Bosnjë-Hercegovinë të një grupi të asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në operacionin "ALTHEA" të Bashkimit Europian", miratuar me ligjin nr.9907, datë 24.4.2008, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimi ditor për ushtarakët shqiptarë të dërguar në Bosnjë-Hercegovinë, në kuadër të operacionit "ALTHEA" të Bashkimit Europian, të jetë 6 000 (gjashtë mijë) lekë, për çdo ditë qëndrimi në këtë mision.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Vendimi nr.477, datë 23.6.2005 i Këshillit të Ministrave "Për shpërblimin e ushtarakëve, pjesëmarrës në operacionin "ALTHEA" të Bashkimit Europian, në Bosnjë-Hercegovinë", i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.14, datë 7.1.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË KËTË PROGRAM STUDIMESH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës në informatikë.
 2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në informatikë”.
 3. Ky program studimesh e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
 4. Kohëzgjatja e këtij programi të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.
 5. Kuota e pranimit në programin e studimeve të doktoratës në informatikë, për vitin akademik 2009-2010, është 10.
 6. Nga kuota e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, caktohet një kuotë për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, e cila administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.
 7. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
 8. Tarifa e shkollimit për këtë program studimesh të doktoratës është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara, nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës.
 9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.
 10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.15, datë 7.1.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E INXHINIERISË SË NDËRTIMIT TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË KËTË PROGRAM STUDIMESH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 dhe 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës në “Inxhinieri ndërtimi”, i cili realizohet me tri profile:

- a) Në inxhinieri ndërtimi, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në inxhinieri ndërtimi”.
- b) Në inxhinieri hidroteknike, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në inxhinieri ndërtimi, me profil inxhinieri hidroteknike”.
- c) Në inxhinieri mjedisi, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në inxhinieri ndërtimi, me profil inxhinieri mjedisi”.
2. Ky program studimesh e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
3. Kohëzgjatja e këtij programi studimesh të doktoratës është, të paktën 3, vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.
4. Kuota e pranimit në këtë program studimesh, për vitin akademik 2009-2010, është 14.
5. Nga kuota, e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, caktohen dy kuota për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.
6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
7. Tarifa e shkollimit, për këtë program studimesh të doktoratës, është 2 00 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara, nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës.
8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.
9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.16, datë 7.1.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E HISTORISË DHE FILOLOGJISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, si më poshtë vijon:
- a) Në “Kërkime gjuhësore”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në kërkime gjuhësore”.
- b) Në “Studime letrare” në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në studime letrare”.
2. Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
3. Kohëzgjatja e programeve të mësipërme të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.
4. Kuotat e pranimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, janë, si më poshtë vijon:
- | | |
|-----------------------------------|-----------|
| a) Doktoratë në kërkime gjuhësore | 60 kuota; |
| b) Doktoratë në studime letrare | 15 kuota. |

5. Nga kuotat e përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, për çdo program studimi, caktohen, për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, kuotat e mëposhtme:

- a) Doktoratë në kërkime gjuhësore 6 kuota;
- b) Doktoratë në studime letrare 2 kuota.

6. Kuotat për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

7. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Tarifa e shkollimit, për këto programe studimi të doktoratës, është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara, nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.17, datë 7.1.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.998, DATË 30.9.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE,
BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE DHE TË STUDENTËVE, NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2009-2010”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 57 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 42 të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “a” e pikës 2.3 të vendimit nr.998, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) Fëmija, nxënës apo student, i punonjësit të Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura apo i Shërbimit Informativ të Shtetit, që ka humbur jetën në krye e për shkak të detyrës. Në fillim të çdo viti akademik, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listën emërore të tyre.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR-të/ZA-të dhe institucionet e arsimit të lartë e njësitë e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.18, datë 13.1.2010

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA MJEDISEVE, NGA
MINISTRIA E BRENDSHME AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN
ELEKTRONIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të ndërtesës së ish-policisë ndërtimore, dega Tiranë, aktualisht në përdorim të AKCE-së, nga Ministria e Brendshme Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.


2. Ky ndryshim të reflektohet në listën e miratuar me vendimin nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**Planimetria e katit të parë
Arkivi Shtetëror i Sistemit
AKCE**



VENDIM
Nr.19, datë 13.1.2010

PËR LIRIMIN DHE MANDATIMIN E DISA ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 20 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lirimim nga detyra e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të znj.Lindita Lati, për shkak të përfundimit të mandatit, dhe të z.Skënder Uku, për shkak të emërimit të tij në një detyrë tjetër, jashtë sistemit të financave.

2. Mandatimin, si anëtarë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të:

- z. Federik Çuçllari, propozuar nga universiteti “Fan S. Noli”, Korçë;
- znj.Arjana Dyrmishi, propozuar nga Ministri i Financave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.23, datë 20.1.2010

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE BËRTHAMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare Bërthamore (më poshtë AKOB), si institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me statusin e personit juridik publik, me seli në Tiranë që e zhvillon veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës të Shqipërisë. AKOB-i ka vulën dhe stemën e vet zyrtare.

2. AKOB-i ka objekt të veprimtarisë përgatitjen, ndjekjen e mbarëvajtjes dhe të zhvillimit të programit kombëtar bërthamor, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit.

3. Detyrat dhe objektivat e AKOB-it janë:

- Ngritja dhe mirëfunksionimi i infrastrukturës së nevojshme, në mbështetje të programit kombëtar bërthamor.

- Hartimi i kuadrit të plotë ligjor, i cili do të mbështesë zhvillimin normal të programit.

- Hartimi i kuadrit të nevojshëm rregullator, në shërbim të programit.

- Bashkërendimi i punës për përzgjedhjen e vendeve, në të cilat mund të ndërtohet centrali bërthamor.

- Përzgjedhja dhe sigurimi i përgatitjes profesionale të personelit të nevojshëm, në mbështetje të programit bërthamor, në faza të ndryshme të tij.

- Hartimi i dokumentacionit dhe ndjekja e procedurave, në bazë të të cilave do të kërkohen oferta për centralin bërthamor.

- Ndjekja, gjatë të gjitha fazave, e procedurave dhe ecurisë për ndërtimin dhe vënien në funksionim të centralit bërthamor.

- Sigurimi i ruajtjes, afatshkurtër dhe afatgjatë, së lëndës djegëse bërthamore, si dhe të materialeve radioaktive, të cilat lidhen me procesin e prodhimit të energjisë nga centrali bërthamor.

- Njohja e popullatës dhe e grupeve të interesit me programin bërthamor, gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të tij.

- Vlerësimi i zhvillimit, sipas planifikimit dhe parashikimit të fazave të ndryshme të programit bërthamor.

4. AKOB-i, për të realizuar misionin dhe objektivat e saj, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë mes institucioneve të ndryshme të vendit, publike dhe/ose private, të grupeve të interesit, vendase dhe/ose të huaja dhe konkretisht:

- Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA);

- struktura të ngjashme të vendeve të ndryshme të rajonit dhe të botës;

- universitete dhe institucione kërkimore, në fushat që mbulon dhe përfshin programi kombëtar bërthamor;

- institucione jofitimprurëse e donatorë të ndryshëm, vendas dhe/ose të huaj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

5. AKOB-i është institucion buxhetor dhe financohet nga:

- Buxheti i Shtetit;

- burime financiare nga palë të treta, të destinuara për programin kombëtar bërthamor, nga fonde të institucioneve ndërkombëtare, të shteteve të veçanta dhe të organizatave të ndryshme, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

- donacione të subjekteve fizike dhe/ose juridike, nga sektori privat, vendas dhe/ose i huaj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

6. Organet drejtuese të AKOB-it janë:

- Këshilli drejtues,

- Kryetari.

7. Përbërja e këshillit drejtues përcaktohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin. Funksionimi dhe detyrat e këtij këshilli përcaktohen në statutin e AKOB-it. Statuti dhe rregullorja e funksionimit propozohen nga kryetari i AKOB-it dhe miratohen nga këshilli drejtues. Këshilli drejtues miraton buxhetin, planin e përgjithshëm të veprimtarive, si dhe dokumentet strategjike të AKOB-it.

8. Kryetari është titullari i institucionit dhe përfaqëson AKOB-in në marrëdhënie me të tretët. Emërimi, lirimi dhe shkarkimi nga detyra e kryetarit të AKOB-it bëhen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin.

9. Struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare Bërthamore miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

10. AKOB-i i raporton një herë në vit Kryeministrit e, në mënyrë periodike, Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, për ecurinë dhe zhvillimin e programit bërthamor në vend.

11. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKOB-it rregullohen me Kodin e Punës. Procedurat e emërimit dhe të liritimit nga detyra të punonjësve të AKOB-it bëhen në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe me aktet nënligjore në fuqi. Niveli i pagave të punonjësve të AKOB-it përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi.

12. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave të marrë masat e nevojshme për sigurimin e mjediseve të punës për punonjësit e AKOB-it.

13. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

14. Paragrafi i fundit i pikës 3 të vendimit nr.547, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.127, datë 19.1.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.1468, DATË 26.6.2006 “PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.223, DATË 19.4.2006 “PËR PAGESËN E TË ARDHURËS NGA PAPANËSIA” I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.223, datë 19.4.2006 “Për pagesën e të ardhurës nga papunësia”, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.1468, datë 26.6.2006 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.223, datë 19.4.2006 “Për pagesën e të ardhurës nga papunësia” i ndryshuar”, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Pika 13 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“13. E ardhura nga papunësia caktohet mujore dhe paguhet përpjesëtimisht me numrin e ditëve kalendarike, për kohën që përfituesi ka të drejtë ta marrë këtë të ardhur. Pagesa jepet një herë në muaj pranë sportelit të Postës Shqiptare, pasi personi përfitues të jetë paraqitur në zyrën e punësimit. Ajo i jepet vetëm personit përfitues, përkundrejt paraqitjes së dokumentit të identifikimit në sportelin përkatës të Postës Shqiptare.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE
SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA**
Spiro Ksera

KËRKESE

Shtetasi Zef Prebibaj (Dedaj), i biri i Dedës dhe Lules, i datëlindjes 12.4.1939, lindur në Curraj e Epërm, banues në Laprakë, Tiranë, kërkon shpalljen të vdekur të vëllait të tij, Ndue Dedë Deda.

KËRKUES
Zef Prebibaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 26.1.2010
Doli nga shtypi më 27.1.2010

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë